

TERMAT E REFERENCES

PËR MBIKËQYRJEN E PUNIMEVE NË OBJEKTIN:

Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Brezhdan dhe Ushtëlencë, Njesia Administrative Qëndër Tomin, Faza e dyte

Vlerë: 1,332,239.33 Lekë (me T.V.SH)

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Me fondet nga Buxheti i shtetit për vitin 2023 është parashikuar të kryhet mbikëqyrja e objektit: **“Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Brezhdan dhe Ushtëlencë, Njesia Administrative Qëndër Tomin, Faza e dyte”**, sipas fondit limit prej **1,332,239.33** lekë (me T.V.SH) me **Kod Projekti 19AG310**.

Për këtë i kërkohet mbikëqyrësit të punimeve të kësaj kontrate, të kryejë mbikëqyrjen e këtij objekti, me fondin limit të mbikëqyrjes të llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 354 date 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimit”. **Grupi III tarifor, Pika C.**

Vlera e shërbimit të mbikqyrjes së punimeve e llogaritur mbi bazën e fondit limit është 1,110,199.40 lekë (pa T.V.SH) ose 1,332,239.33 lekë (me T.V.SH).

1. OBJEKTIKI KRYESOR I MBIKËQYRJES SË PUNIMEVE

1.1 Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve programon punimet që do të kryhen në objekt nëpërmjet një plani të shprehur në grafik për çdo muaj. Ai mbikqyr grafikun e punimeve, kontrollon librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetesinë e dokumentacionit që mbahet në objekt.

2. DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E MBIKËQYRËSIT TË PUNIMEVE

2.1 Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projektit, Mbikëqyrësi menjëherë pas lidhjes së kontratës duhet:

2.1.1 Të mbikëqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas kontratës së nënshkruar dhe sipas Ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998, U.K.M Nr.3 datë 15.02 2001, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë 16.06.2011, U.K.M Nr. 1 date 22.02.2005, U.K.M Nr 2 datë 13.05.2005, Vendimi Nr.610 datë 22.09.2022 dhe të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim.

Të njihet në detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standardeve të përcaktuara me ligj.

2.1.2 Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë te zhvilluesi, çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi.

2.1.3 Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor stafin e tij Mbikëqyrës, siç është përcaktuar në kërkeshat e stafit kryesor.

2.2 Drejtuesin e punimeve dhe Mbikëqyrësin e materialeve dhe cilësisë që duhet të jetë Inxhinier Hidroteknik ose Ndërtimi me licencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, certifikaten e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, ndjek dhe miraton cilësinë e produkteve, korrespondecën me Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër, miraton materialet dhe cilësinë e tyre, ndjek e miraton vendosjen e tyre në objekt dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2.2.1 Inxhinieri për punimet topografike që duhet të jetë inxhinier topograf me licencë Profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton piketimet dhe kuotëzimin e objektit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2.2.2 Inxhinieri për punimet ndërtimore që duhet të jetë inxhinier ndërtimi me licence profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2.2.3 Inxhinieri për punimet ndërtimore që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me licence profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

Shënim: Në bazë të volumit të punimeve dhe vleftës së kontratës drejtuesi i punimeve duhet të jetë rezident në objekt dhe stafi tjetër mbikëqyrës mund të jetë rezident çdo ditë në objekt ose me kohë të pjesëshme.

- 2.3** Mbikëqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontrakton me Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin dhe probleme të ndryshme që mund të lindin gjatë zbatimit.
- 2.4** Mbikëqyrësi vihet në dijeni nga Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi në përputhje me kontratën e nënshkruar.
- 2.5** Mbikëqyrësi në fillim të punimeve në objekt merr kontakt me organet qeverisëse lokale ose qendrore në juridikcionin e të cilit ndodhet zona e ndërtimit ku kryhen punimet e këtij objekti dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me nenin 9 të Ligjit Nr.8402 dt.10.09.1998.

3. DETYRAT E MBIKËQYRËSIT

3.1 Mbikëqyrësi ka për detyrë:

- 3.1.1** Të bëje verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të liçensave të autorizimeve dhe të lejeve që sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
- 3.1.2** Të bëje verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.
- 3.1.3** Të njihet me hollësi me kontratën e sipërmarrësit dhe të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundëshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- 3.1.4** Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit me të dhënat e mëposhtme:
Emërtimi i objektit:
Data e marrjes së lejes së ndërtimit:
Investitori:
Projektuesi:
Sipërmarresi dhe drejtuesi teknik:
Mbikëqyrësi:
Afati i ndërtimit të objektit:
Vlera e objektit (me TVSH)

3.2 Mbikëqyrësi menjëherë pas lidhjes së kontratës duhet:

- 3.2.1** Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese, treguese, të sigurisë, shiritave, fenerëve etj, sipas dokumentacionit të vlerësimit të rrezikut, (Vendimi Nr.312 date 05.05.2010 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për sigurimin në kantier i quajtur plani i sigurisë dhe koordinimit") (PSK).
- 3.2.2** Pas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër të gjithë dokumentacionin si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku përfshihen:

- Stafi i sipërmarrësit;
- Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit;
- Laboratori i licensuar që do të kryeje testet e materialeve;
- Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së nënshkruar;
- Të kontrolloje zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt - zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet nëse ka, t`i propozojë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër zgjidhjet konkrete;
- Të ndjeke në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta duke dhënë udhëzime, porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të dispozitave përkatëse të kontratave;
- Të kërkojë të zbatojë në mënyrë korrekte plan - organizimin e punimeve të objektit;
- Të kërkojë dhe të zbatojë lejen (autorizimin, pëlqimin) mjedisore të miratuara nga organi kompetent;
- Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme pikëtimin e objektit, kuotat e thellësisë së kanaleve dhe kuotat e vendosjes së veprave të artit;
- Të respekoje dokumentacionin përkatës kur objekti ndërtohet në zonat turistike, arkeologjike apo të trashëgimisë kulturore;
- Të kontrollojë bazamentin e objektit dhe të japë miratimin e tij për vazhdim të punimeve;
- Të kontrollojë çdo material që vendoset në vepër dhe mënyrën e vendosjes së tij dhe standartet e cilësisë së materialeve;
- Për çdo punim të dukshëm ose të padukshëm në të gjitha fazat e ndërtimit të bëjë fotografimin ose regjistrimin e tij dhe të mbaje proces-verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit;

(Formati tip sipas Vendimit Nr.610 datë 22.09.2022 sipas shtojces 7 dhe 8)
- Në fund të çdo dite pune të kontrolloje ditarin e punimeve dhe të firmose atë;

(Formati tip sipas vendimit Nr.610 datë 22.09.2022 sipas shtojcës 5)
- Të kontrollojë situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi në fazat e ndryshme të punimeve dhe miratojë ato;

(Formati tip sipas Vendimit Nr.610 datë 22.09.2022 sipas shtojcës 12)
- Të kontrollojë librezën e masave ku pasqyrohen vëllimet metrike, gradualisht me zhvillimet e tyre;

(Formati tip sipas Vendimit Nr.610 datë 22.09.2022 sipas shtojcës 4)
- Të kontrollojë çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe të jape miratimin për vendosjen e tyre në objekt;
- Të njoftojë sipërmarrësin për difektet e vëna re dhe kohën e korrigjimit të tyre;
Punimet me difekte nuk pranohen dhe nuk financohen deri në korrigjin e tyre.
- Gjatë zbatimit të projektit i jep instruksione me shkrim sipërmarrës të herë që e sheh të nevojshme dhe sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë nga mbikëqyrësi i punimeve;

- Për çdo rast që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projekt-Preventivin e parashikuar, mbikëqyrësi i punimeve duhet të paraqesë pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër, një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi i miratuar edhe nga projektuesi dhe më pas ky ndryshim do të zbatohet në objekt vetëm pas miratimit nga Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër;
- Të nënshkruajë aktin përfundimtar të kontrollit të punimeve përfaza të ndryshme;
- Në çdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqesë pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër raport mënyrë të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tabllo e qartë e avancimit të punimeve, pagesave të kryera, realizimine punimeve në vlefte dhe %, afatin kohor të realizimit të financimit;

Raporti mënyrë do të ketë këtë përbajtje:

- Hyrje
- Informacion i përgjithshëm
 - Të përgjithshme;
 - Qëllimi i punimeve;
 - Mbikëqyrja e punimeve ndërtimore;
- Personeli i siguruar nga Mbikëqyrësi
 - Stafi i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve;
 - Stafi aktual;
 - Kohëqëndrimi në objekt për secilin;
- Raportimi
- Kohëzgjatje e shërbimit të Mbikëqyrjes
- Përshkrimi i projektit sipas nënobjekteve përkatëse
 - Burimet ose pushtimet
 - Depot
 - Linjat e Ujësjellësit, (rrjet kryesor, rrjet sekondar, terciar), etj:
- Organizimi i Sipërmarrësit
 - Sipërmarrësi;
 - Stafi prezent;
 - Mjete dhe makineri;
 - Kohëqëndrimi në Objekt;
- Progresi mënyrë
- Përshkrimi të punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave)
- Fotografi të proceseve të punëve të kryera
- Fotografi të punimeve kryesore të dukshme ose të padukshme.
- Grafiku i ecurisë së punimeve
 - Të aprovuara
 - Të kryera
- Volumet progresive të punimeve mënyrë
 - Punimet e aprovuara
 - Çertifikatat e cilësisë dhe testet laboratorike

- Libreza e masave
- Punimet e kryera por të pa aprovuara
- Situacionet mujore
- Matjet topografike
- Korespondenca
 - Proces - verbale
 - Urdhëresa, Udhëzime, Njoftime;
 - Ndryshime në Projekt dhe Preventiv nëse ka (të aprovuara nga AKUM);
- Moti (kalendarik)
- Problemet që kanë dalë
 - Teknike
 - Sociale
- Konkluzione

Shënim: Raporti mujor dhe dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, në pesë kopje dhe tre kopje, të dorëzohen në Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër.

Raporti mujor do t'i dorëzohet Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër brenda datës të aktuar në kontratë.

Konsulenti do të mbajë kontakte të vazhdueshme me Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër, Drejtoria Teknike dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.

4. PËRGJEGJËSITË E MBIKËQYRËSIT

4.1 Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit (sipas Ligjit Nr.120 datë 07.10.2020, Neni 7.1, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8402 dt 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar.)

4.2 Me fillimin e punimeve mbikëqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e objektit si më poshtë vijon:

1. Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikimet teknike;

2. Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet;
3. Realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike;
4. Saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit;
5. Për realizimin pikë për pikë të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarrësit dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër, për realizimin e të gjithë fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit;
6. Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit. Sipërmarrësi duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij;
7. E gjithë korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me investitorin dhe me sipërmarrësin përbën dokumentacionin e plotë të objektit dhe si e tillë ruhet me çdo kusht ku pasqyrohen të gjitha aktet, urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontraditat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuaara ose të paraqitura gjatë zbatimit si dhe të gjitha rrëthanat e nevojshme.
8. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit të punimeve të mbahet proces-verbal i dorëzimit të punimeve, ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri.
9. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër kontrollon praninë e mbikëqyrësit të punimeve në objekt dhe në rast konstatimi të mungesës së tij nxjerr vendim për pezullimin e punimeve deri në emërimin dhe praninë e tij në objekt;

5. TË DREJTAT E MBIKËQYRËSIT

5.1 Mbikëqyrësi ka të drejtë:

- 5.1.1** Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë në punë;
- 5.1.2** Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor, n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar;
- 5.1.3** Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun;
- 5.1.4** Të mos lejojë vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësojë ato me materiale të tjera nga sipërmarësi me shpenzimet e tij;
- 5.1.5** Të kërkojë certifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materialeve;
- 5.1.6** Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit;
- 5.1.7** Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër, dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurta dhe cilësore;
- 5.1.8** Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike;

- 5.1.9** Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi këto duhet të dokumentohen me proces-verbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik ku të argumentohen shmangjet e palejuara, referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt-zbatimit;
- 5.1.10** Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt kur këto nuk janë kryer në masën sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit;
- 5.1.11** Të kërkojë kryerjen e provave me ngarkesë ose pa ngarkesë sipas Standardeve Shqipëtare të miratuara nga Drejtoria Përgjithshme e Standartizimeve, K.T.P apo K.T.Z në fuqi për tubacionet e vendosura në objekt;
- 5.1.12** Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka dëmtime të rënda, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i jepin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.
- 5.1.13** Mbikëqyrësi i punimeve urdhëron sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në projekt-zbatimin ose Specifikimet Teknike.
- 5.1.14** Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast sipas fajit, mbikëqyrësi së bashku me Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër dhe sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit të punimeve dhe të ndryshimit të shpenzimeve.
- 5.1.15** Mbikëqyrësi duhet të firmosë gjithë dokumentacionin që ka miratuar, ai mban përgjegjësi ligjore së bashku me sipërmarrësin. Një kopje e dokumentacionit të miratuar nga mbikëqyrësi i dorëzohet kolaudatorit ose grupit të kolaudimit të objektit.
- 5.1.16** Mbikëqyrësi merr pjesë në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit ose grupit të kolaudimit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës si dhe firmos proces-verbalin e kolaudimit;
- 5.1.17** Mbikëqyrësi kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër për gjëndjen e tij, në rast se Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër ka vërejtje e njofton sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet midis tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

5.2 Në përfundim të punimeve Mbikëqyrësi:

- 5.2.1** Mbikëqyrësi me kërkesë të sipërmarrësit vërteton në proçes-verbal datën e përfundimit të punimeve sipas projektit, kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara në kushtet e kontratës dhe brënda 30 ditëve merr prej tij dokumentacionin përkatës.
- 5.2.2** Duke u mbështetur në Ligjin 8402, datë 10.09.1998, U.K.M Nr 2 date 13.05.2005 dhe U.K.M Nr.3 datë.15.02.2001 i ndryshuar me udhëzimin Nr.1 date 16.06.2011, Vendimi Nr.610 datë 22.09.2022, dorëzon pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër (Drejtoria Teknike) të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin, saktësinë dhe vërtetësinë e tij.

Dokumentacioni duhet të përbajë;

1. Proçes -verbalin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit;
2. Proçes-verbalin për fillimin e punimeve;
3. Kontratën e sipërmarrësit;
4. Kontratën e mbikëqyrjes së punimeve;
5. Projekt organizimin e punimeve;
6. Projekt - Zbatimin, të miratuara nga organi, i cili ka te drejte sipas juridiksionit dhe oponencës teknike
7. Projekt - Zbatimin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korrespondencën, skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme;
8. Preventivin e plote te projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjiths volume e punimeve, të hartuara nga projektuesi
9. Preventivin e ndryshuar (nëse ka zëra të rindërtimit të punimeve, negocimin e tyre)
10. Plan organizimit te punimeve të ndërtimit, i cili përmban planin e ngritjes dhe organizimit të kantierit, grafikut e pergjithshem te punimeve dhe planin e veprimit per ndertimit e objektit sipas projektit, në përpjekje me afatet dhe kushtet e kontrates. Grafiku i punimeve;
11. Specifikimet teknike;
12. Azhornimi para fillimit të punimeve dhe pikëtimi i objektit;
13. Dokumentacioni topografik dhe gjeologo-inxhinierik;
14. Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi për punimet e dukshme dhe të padukshme;
15. Proçes-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi i punimeve të shoqëruar me fotografitë përkatëse;
16. Ditari i objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga mbikëqyrësi;
17. Libreza e masave;
18. Shkresën e mbikëqyrësit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezervë shoqëruar me dokumentacionin përkatës:
 - Proçes - verbal i përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga (Sipërmarrësi, drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi i punimeve;
 - Preventivi i fondit rezervë të firmosur nga sipërmarrësi (Drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi i punimeve;
 - Situacioni i fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi i punimeve.

19. Çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe testet laboratorike të materialeve të përdorur në objekt;
20. Miratimi i materialeve të përdorura nga mbikëqyrësi i punimeve;
21. Situacionet pjesore dhe atë përfundimtar:
22. Regjistri i kontabilitetit të shpenzimeve;
23. Deklarata teknike e sipërmarrësit e firmosur nga sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik;
24. Njoftimi i sipërmarrësit për përfundimin e punimeve;
25. Dokumentin e vlerësimit të rrezikut sipas Vendimit Nr.312 datë 05.05.2010 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për sigurimin në kantier i quajtur plani i sigurisë dhe Koordinimit (PSK);
26. Proçes- verbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar;
27. Relacionin përfundimtar i mbikëqyrësit të punimeve;

(Formatet tip të dokumentacionit të jenë sipas formatit tip, sipas Vendimit Nr.610 datë 22.09.2022)

I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e mbikëqyrësit të punimeve.

Dokumentacioni është në 3 (tre) kopje, një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë kolaudatorit ose grupit të kolaudimit që ngrihet me urdhër të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve në objekt.

Të gjitha dokumentat që dorëzohen tek Kolaudatori ose në Grupin e Kolaudimit pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër, duhet të jenë origjinale.

- Mbikëqyrësi i punimeve merr pjesë në kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet grupit të kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe firmos proçes-verbalin e kolaudimit.
- Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe dokumentacionin tjetër përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe i jepet për likujdim Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër.

6. KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKËQYRJES

- 6.1** Kohëzgjatja e shërbimit të mbikëqyrjes do të jetë për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve deri në përfundimin e objektit (përshirë dhe zgjatjen e afatit të kontratës së sipërmarrësit).
- 6.2** **Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë largimin e Mbikëqyrësit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:**
 - 6.2.1** Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara.
 - 6.2.2** Ndërprerje të paarsyeshme të punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.

- 6.2.3** Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike;
- 6.2.4** Kur konstatohen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër ka të drejtë të urdhëroj mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes.
- 6.2.5** Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative vendosen sanksione në bazë të neneve 15 dhe 16, të Kreut III të Ligjit Nr.8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.